



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 23

Datë: 02. 06. 2017, ora: 12:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr 20/2017

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

3. Aktivitetet e ZRPP-së.

- Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve grupi i katërt

4. Raport i Këshillave të KQZ-së.

- Këshilli për Operacione Zgjedhore;

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të KKZ-ve për ndryshim të Lokacioneve për QV lidhur Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017 sipas Komunave;

- Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-ve, për komunat, Zveqan, Leposaviq, Mitrovica e Veriut dhe Zubin Potok për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për numrin e fletëvotimeve dhe broshurave të cilat shtypen dhe shpërndahen për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017;

5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.

Valdete Daka: Fillojmë më mbledhjen e 23 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka ndokush propozim, ngjashëm...? Ndonjë pikë të rendit të ditës me shtuar apo me larguar? Nëse jo atëherë kush është për?

Betim Gjoshi: Një analizë prej Sekretariati për një pikë të rendit të ditës, por ndoshta nesër e kanë apo të fundit se, nuk ka kuptim ajo punë.

Valdete Daka: Mirë, atëherë fillojmë me shqyrtimin e procesverbalit të mbledhjes nr.20/2017. A ka dikush vërejte ne këtë...? Nëse jo, kush është për? Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë procesverbal. Shkojmë me pikën tjetër. Atëherë, fillojmë... Krye shef, urdhëro...!

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

Enis Halimi: Për sa i takon listës përfundimtare pasi certifikimit të listave divizioni përkatës ka bërë shtypjen e ashtuquajturës skedar të PDF për listat përfundimtare të votuesve, dhe lista komunale të votuesve të përdorur në votime dhe qendra të votimit. Sot, d.m.th. do të bëhet dorëzimi dhe ku do të filloj prej nesër edhe shtypja e këtij materiali e cila përfundon brenda disa ditëve. Periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve me nevoja të veçanta janë kategoria e votuesve në shtëpi ka përfunduar më 28 maj. Deri me tani të dhënat e votuesve nga 28 komuna numri i regjistruar në këtë kategori deri me tash është 963 votues të regjistruar në 28 komuna të Kosovës. Ndërkaq sa i përket kategorisë së dytë votuesit të institucioneve ne kemi vendosur kontakte me shërbime korrektues dhe kemi pranuar të dhëna në disa qendra të paraburgimit dhe në burgje lidhur me regjistrimin e votuesve në këto institucione të sigurisë, është përgatitë plani për fillimin e trajnimit e të gjithë anëtarëve të komisioneve të këshillave të vendvotimeve dhe po ashtu të dimensioneve tjera në kuptim të logjistikës të administratës. Ne përgjithësisht në departament në çështje ligjore dhe po ashtu në fund e kemi një pasqyrë për tubime politike të mbajtura nga fushata zgjedhore që është një raport ditor.

Valdete Daka: Faleminderit! a ka dikush pyetje për shefin.

Betim Gjoshi: mendoj që kryeshefi duhet deri ne fund të orarit me na dërgu emrat e antarëve të këshillave të vendvotimeve përfshirë edhe garancionin që ata janë verifikuar sipas ligjit në fuqi, listën e vend votimeve për secilën qendër të fletëvotimeve në qendrën e votimit se duhet mi pas, ka ardhur koha për mi pas si anëtar te komisionit qendror zgjedhor. Unë thash sot kryeshef, mirëpo bën edhe nesër nëse nuk i keni gati edhe pse është dashur mi pas si anëtar të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Enis Halimi: Më falni nëse mundem? I kemi edhe ne. I kemi verifikuar në listën botuese tani procesin për verifikim në ato hallakat e zakonshme I kemi në prokurori dhe këtu, besoj dhe ai do të bëhet shpejt mirëpo nëse dhe ju I miratoni si të tillë në listën votuese dhe në komunën përkatëse si votues dhe kur përfundon që mos me humb kohë për punë të trajnimit, kur përfundon procesi paralel i verifikimit me prokurorin atëherë ata emra që eventualisht nuk konfirmohen si të rregullt nga prokuroria nëse ka ndonjë precedent eventual ata tërhiqen dhe kërkohen për zëvendësimin e tyre, që mos me prit për të gjithë deri sa të bëhet verifikimi sepse është proces që mundë të merr kohë.

Valdete Daka: Faleminderit, kryeshefe! E përmendi që është tu e përgatit për planet e trajnimit për anëtarë të KVV-së, dhe shpërndarjen e doracakëve te trajnimit dje është ngritë një çështje një temë që ngriti betimin që përkrahi të gjithë anëtarët e tjerë të komisionit, unë mendoj që sa I përket temës e cila është ngritë e cila ka të bëjë me proces të numërimit të votave te vendvotimeve paraprakisht ne duhet të bisedojmë për këtë çështje ti marrim qëndrimet tona, në mënyrë që kjo pjesë e trajnimit dhe pjese e dokumenteve e doracakut, një udhëzues që ka të bëjë me procesin e numrit te votave në kuptim të transparencës dhe sigurisë të votës.

Adnan Rustemi: Po, është e vërtet që neve na duhet lista e vendvotimeve, qendra e vendvotimit përfundimtar dhe numri të votuesve për çdo vendvotim, madje ju duhet dhe vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtar është mirë me ja u përcjell sepse kanë nevojë me dite për nevoja të logjistikës me distribuuar vëzhguesit. Dhe e dyta, është kjo çështja e komisionereve. Është mirë me na u dërguar lista, përfundimtare, fillestare jo me na u dërguar pjesë pjesë që mos me mundur mandej se ku ka filluar dhe ku përfunduar, unë pajtohem mbase jo sonte, nesër ta kemi në fillim të ditës ose në pjesën e parë të takimit e di se një here përfundimtare të atyre që konsiderohen që nga sekretariati , janë verifikuar dhe janë vendosur. Pastaj nëse del diçka hiqet ose shtohet , është tjetër gjë. Çështja është se duhet me ngritë. Ka disa komuna të cilat nuk janë duke i përfillur vendimet e djeshme të Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve mbi formulën. Ne kemi vendosur mbi përbërjen e KVV-së d.m.th ne kemi caktuar numra dhe kjo nënkupton se diku duhet që me dërguar listë shtesë e kemi të qartë se edhe

disa zyrtarë komunal kinse po refuzojnë për me pranuar emrat , shtesë unë po kërkoj prej kryeshefit që me kërkuar për me e marrë me seriozitet në këtë aspekt dhe ne vendimet e KQZ-së dje vendime për secilën komunë dhe këto vendime me u zbatuar, na dalin komisioner të pa autorizuar në ditën e zgjedhjeve ne na krijojnë probleme serioze kisha me thanë. E kam Skenderajn, komunën e parë që Skenderaj i Lëvizjes Vetëvendosje nënkupton me I pas 128 komisioner. Zyrtari komunal dje tërë ditën, sot tërë ditën refuzon me e pranuar listën shtesë. Nuk po kuptoj. Jam detyruar me dërguar e-mail kryeshefit mos me jap përgjigje se çfarë keni marrë, s`e nuk e di a është e konfirmuar, por nuk po e kuptoj. Nuk e kam pas mendjen me ngirtë, a me pas zgjidhje.

Betim Gjoshi: Kryetare, a bën? Në këtë problematike kur të vijmë te KVV-të kush është Skenderaj që janë nja 7-8 komuna dje kemi kërkuar me i plotësuar, se pas vërejtjeve në qoftë se këta nuk i respektojnë dhe në bazë të asaj këta bëjnë shkelje ligjore dhe s`kemi çka me diskutuar aty nëse s`ka nominime. Kemi thënë atëherë është tjetër muhabet nëse nuk do me dërguar.

Enis Halimi: Kryetare jemi marrë vazhdimisht me këtë punë dhe jemi telashe bukur të mëdha ne komunikojmë më zyrtarët tonë komunal ata i dërgojnë krejt nominimet. Deri ne atë moment ata i kanë. Po flas ne kemi shfrytëzuar çdo formë të komunikimit ndoshta vetëm deri tek prezenca fizike e tyre këtu ose neve atje. Vetëm kjo ndoshta ka munguar. Deri në atë moment që kanë pasur ata prej subjekteve të caktuara politike , çfarëdo qofshin ato, po flas përgjithësisht, pa e specifikuar ndonjë komunë, ata zotohen që me besnikëri i kanë përcjellë. Tani ne kemi insistuar që konform vendimeve.

Adnan Rrustemi: Është ikje prej çështjes. Nëse i kanë dërguar, nëse i kanë përcjellë listat që i kanë pasur deri dje krejt në rregull është, por, nga dje në disa raste ka ndryshuar numri dhe zyrtarët komunal nëse jo sekretariati, ishte dashur ti kontaktoj ato subjekte politike në këto komuna mi thënë dërgoni numrin shtesë , tash këta lëre se nuk e kanë bërë njoftimin, por, nuk I pranoj as ata që I kemi njoftuar ne, a po e kuptoni? Nuk po e pranojnë listën. Megjithatë ndoshta duhet me ekzistuar një kufi, deri kur subjekti politik ka të drejtë me ndryshuar numra.

Valdete Daka: Deri kur të filloj trajnimi...?

Enis Halimi: Ka raste kur është kalkuluar drejtë dhe nuk është kalkuluar mirë, nuk e di a prej zyrtareve këtu apo prej KKZ-së atje, mirëpo çështjet janë konfuze në teren kështu që duhet mu marr masa.

Valdete Daka: Po Ercan...!

Ercan Spat:Të përfundojmë bile atë, nuk shkojmë më tutje, sinqerisht me kursye vetveten jo juve , nuk dështa me fol fare për këtë çështje , por, diskutimi I kolegëve domosdo njeriun e bjen në situatë mu inkuadru, sinqerisht unë në jetën time shumë pak nënçmime, ofendime njerëzore kam përjetuar prej sekretariatit çfare kamë përjetuar mbrëmë deri sot në këtë moment, sepse kam kërkuar në vend zyrtarë në KQZ legjitime bile e dini çka kam deklaruar dje, kisha me votu krejt si ka qenë, vetëm kërkoja përgjigje dhe për përgjigje mora se jam gënjeshtarë, se nuk e foli të vërtetën e çka po di unë, edhe kam marr herën e parë në jetën time sa jam këtu në kontakt direkt me zyrtarët komunal, unë kam pasur gjithnjë respekt për hierarkinë ashtu edhe kësaj here kam vepruar, e-mail i kam dërguar as përgjigje as asgjë, veç u desht edhe personalisht me dëgjuar ofendimet e njerëzve. Faleminderit.

Valdete Daka: Me të vërtetë duhet me shpjeguar këtë, sepse në fakt nuk jam duke e kuptuar çka ka ndodhur.

Betim Gjoshi: Kryetare kështu ka ndodhur, e para, KKZ-të nuk kanë kryer punën e tyre, e dyta, sekretariati pas pranimit të KKZ-ve nominimet kur i ka pa që nuk janë formuar në rregull është dashur ti kthej, e jo mi sjell te na, e na mi kthye, e treta, kjo formë e nominimeve ekziston në KQZ-së të paktën prej 2007, 2 nominime normal që nuk ka tjera kur I thua që nuk ti pranoj. Adanani e ngriti komunën , kam informacion për një komunë tjetër e që ju ka thënë që nuk ti marr dmth kur zyrtari komunal i thotë nuk ti marr, atëherë normal që kjo puna i bjen që ti nuk ke nominime tjera se ski qysh mi pranu kur i thua që nuk ti marr dmth ka qenë dje një vendim me respektua një formulë fillestare, nëse nuk do subjekti nuk mundemi mi detyru me zor, vetëm duhet me gjetë një mundësi qysh me pas rezerva trajnur që mos me na dështu procesi ditën e zgjedhjeve, kaq, dmth Ercani element tjetër mundësi plotësimit 10 përqinshit të rezerveve kaq ka qenë muhabeti, po një gjë duhen mi kuptu dy mbledhje të këshillit se dje Iliri me të drejtë tha a keni mbajtur këshillë , dy herë kemi mbajtur mbledhje dje ne KQZ-së pop rap sot me të njejtën tem po merremi, se nuk po lëviz më tutje, e kanë gjetur një arsye qka me ju bë, ska qka tju bëjë anëtarëve të KKZ-së, zyrtarët komunal janë zyrtarë tanë, egziston procedura me ju jap vërejtje, po ama ti nëse zyrtarëve komunal u fol me telefon dhe u bënë pazare me ta, atëherë normal që nuk mundesh mi dhënë vërejtje. Ekziston në jug enveri në perëndim e lindje mundesh me ju dhënë vërejtje dmth për neve, na e kemi trajtu krejt Kosovën njejtë dhe jemi bërë zemergjerë e jemi mundu gjithëpërfshir e shmangje prej të drejtës së partisë kryesore parlamentare ne vendë për ti dhënë një hapsirë të barabartë të gjithve. Përfaqësim të komuniteteve jemi mundu ne edhe për formul nuk është dashur temë, se na akuzoj ne një anëtarë se këshilli ka bërë formul, jo formul nuk bënë as KQZ-ja as këshilli, ishte dashur me bo sekretariati mi implementu, por, tu e parë nuk kanë gatishmëri e na bëjnë llug as me 12 qershor nuk mund ti miratojmë, neve na u ka dashtë mu ul gjakftohtë komunë për komunë me trjatu nuk e kanë marr mundimin as për qato të mbajnë shënime qysh duhet, e mi interpretu, por, kemi ardh te kjo fazë jemi te 4 komunitat e fundit te 7 kemi pasur vërejtje. Unë

ju kam thënë dje nëse nuk i keni shkruar, merrni regjistrimin dëgjoni, nuk ka qenë gjatë mbledhja një orë kemi diskutu për atë temë më së shumti, ndëgjoni edhe merreni sakt për cilën komunë ju kemi dhënë vërejtje e sakta dmth përmirsoni, po vazhdojmë sot më tutje me rendin e ditës e kur të vjen te kjo pikë nëse kemi ndonjë gjë për të thënë, edhe pse jemi qdo ditë duke u vonuar dmth po luhet qëllimisht me afate në fundë, se të shtunën është dashur të kryhen nominimet, neve të hënë na janë sjellë për shqyrtim, të mërkuren për miratim, sot jemi të enjten.

Adnan Rrustemi: Duhet me sqaru, edhe nëse është këndvështrimi, po e zëmë që ka të drejtë në rrespektimin e afateve, nga dje nga vendimet e djeshme të KQZ-së ku janë vendosur për plotësime, ndryshime fillonë aktivitet i ri, a po e kuptom? Nuk mundesh mi thënë një subjekti politik që dje KQZ-ja I ka thënë edhe 5 ose 10 shtesë cilit do, mi thonë nuk i ke sjell të shtunën, a po kuptoni qka jam duke thënë? Si ke sjell të shtunën, e ti sot je tu ja shtu ose tu ja hek a po e kupton? Po nga dje është ngjarje e re në komuna përkatëse , Lipjan, Skënderaj, Mitrovicë, Stërpc e kudo tjetër. Duhet me sqaru këtë punë se nuk ka mundësi, se qoftë për arsye protokolare ti nuk ke qare pa e pranu shkresen , ku guzon mi thënë palës nuk ta marr shkresën, ti nëse don me ja refuzu, refuzoje, por, ti duhet me ja pranu letrën.

Valdete Daka: Kur të mbërijmë të kjo pika, a bënë të diskutojmë kur të vijm te kjo pikë? Se e krym pothuajse, e nuk erdhen në kurfarë përfundimi. Vazhdojmë me këto aktivitetet e ZRPP-së.

3. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve grupi i katërt

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare. Zyra ka përgatitur grupin e katërt të vëzhguesve për akreditim, janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara sipas nenit 54 dhe 55 të ligjit për zgjedhje, dhe nenit 3 të rregullës zgjedhore 07/2013. Janë procesu aplikacionet për një kualicioni, një organizatë ndërkombëtare, tri organizata joqeveritare vendore, një media dhe gjithsej janë 2956 vëzhgues. Desha vetëm të shtoj edhe ato se dje në ditën e fundit janë akredituar vetëm numër dy kurse sot janë edhe emrat e atyre dy vëzhguesve të cilët teknikisht kanë ra dje prej listës. Listat e emrave të organizatave I keni të bashkangjitura si dhe emrat e secilit vëzhgues. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoreshë. Kush është për akreditimin e këtyre vëzhguesve.

Valdete Daka: Atëherë vazhdojmë me raportine Këshillave . Këshilli për Operacione Zgjedhore.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Adnan Rustemi: Sa për korrektësi Këshilli i Operacionit Zgjedhorë nuk e ka trajtu asnjë nga këto pika, por, me qenë se jemi konsideruar si objekt që analizën.

Eshref Vishi: Këto është mirë me trajtuar vetë kryeshefi. E kam fjalën që nuk janë trajtuar në Këshill të Operacioneve Zgjedhore asnjë përveq mund të themë ato nominimet për KKZ të cilat kanë pësuar ndryshime, është mirë kryeshefi gjithë këto pika me na referu edhe me na tregu për këtë që e kemi kthyer për plotësime ku janë ndryshimet dhe për këto dy tjerat që nuk kanë dal në bazë I referon nga fillimi.

Valdete Daka: Pika e parë është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave KKZ-ve për ndryshim të lokacioneve të qendrave të votimit.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të KKZ-ve për ndryshim të Lokacioneve për QV lidhur Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017 sipas Komunave

Adnan Rustemi: Faleminderit. Ashtu sikur kemi mbetur këtu dje që ta përgadisim një analizë, kushtimisht po them, një informacion më të detajuar për arsyet se kanë shtënë deri te ndryshimi i këtyre qendrave të votimit ,I kemi të paraqitura për secilën komunë pra, duke fillu prej Leposaviqin, Rahivecin, Pejën, Shtimen, Ferizajin, Vushtrinë dhe Zubin Putokin. Për këto nëse doni ju futemi për secilën dmth që ti shpjegojë por I keni thash të prezentuara pra, arsyet që ka ndodhë një gjë e tillë , vendi ku kanë qenë, ku është zhvendosur, ka disa qendra që edhe janë rikthyer në ndërkohë aty ku kanë qenë në 2014 e kështu me rradhë, nëse nuk e bëjë tepër unë mund të ju lexoj për secilën në detaje I diskutojmë.

Valdete Daka: Nuk e besoj që janë të interesuar. Po urdhëro.

Enis Halimi: Kemi diskutuar edhe është në rregull dhe e lexova rastësisht rastin e Pejës, rasti i parë i Pejës nuk është se po më duket i domosdoshëm, po thotë KKZ prej performancës së zgjedhjeve parlamentare të 2014 për shkak të rinovimit të shkollës fillore “8 Marsi”, qendra e votimit 17/04 e kemi shfrytëzuar fakultetin “Haxhi Zeka”. Tash kjo qendër po thotë që prapë do të kthehet tek shkolla fillore “8 Marsi” për shkak se shkolla u rifunksjalu që kjo për mu është

dmth se për mu 2014 në "Haxhi Zeka" ideja është se kjo që po na thotë që qendra e 2010 ose 2013 , po kthehemi në 2010 po ndërkohë kjo qendra e 2014 dhe kjo që e kemi caktu tash për të cilën e kemi bërë në informimin publik nuk ka pësuar asnjë ndryshim a po kupton , pyetja është jo pse me dalë në qendër të re , po pse nuk mund të votojnë në qendrën e re të cilën e kemi caktu , në këtë rast nuk ka asnjë arsye që "Haxhi Zeka" është në funksion në institucion , qikjo është përqefi për ndërruar a po kupton

Valdete Daka: Kjo e ka edhe sqarimin poshtë, ku thotë s'e për këto lëvizje janë të njoftuar votuesit, menaxheret e shkollave në të cilat qendra të votimit I kemi dërguar edhe listat preliminare të votuesve, dhe për këtë levizje.

Betim Gjoshi: Krejt kjo çka po thuani ju është e drejte sepse ashtu e kanë shkurar. Por, çka po thot Adnani, është se nuk ka arsye objektive pse ish dashte me u ndërruar. Por, porblemi është, unë dje thash jorastësisht, mirë që na kanë sjellë kët letër sa me na arsyetuar ne. këta I kanë ndërruar këto qendra, ne vetëm kemi më ia bë aminin. Pra, hajde t`a kryejmë, e most ë mirremi me këto sot sepse u bëm horë

Adnan Rustemi: Vetëm mos të na hedhin pluhur syve. Nëse ne Rahovec është në rrezik shkolla ka kuptim me ndërruar. Por, në këtë rast nuk ka ndodhë asgje objective, boll I mirë universiteti. Por, unë jam për.

Valdete Daka: Kush është për? Miratohet.

Betim Gjoshi: Kryetare, i mbetet kryeshefit ekzekutiv që me i njoftuar votuesit, ashtu siç e kërkon ligji për zgjedhjet. Me I njoftuar të gjithë votuesit për ndërrimin e qendrës së votimit, sepse më shërbim nuk mundemi me I ofruar. Nëse kemi ne ditën e zgjedhjeve ankesa, unë ka me dalë publikisht me thënë që fajtorë është sekretariati, sepse unë nuk marr përgjegjësi për veprimin ose mosveprimin e tyre. Sepse këta janë për me na ndihmuar ne, KQZ-së, me i mbajtë zgjedhjet, realisht ne më shumë poi a mbulojmë problemet që po i shkaktojnë, se sa me i ralizuar.

Adnan Rustemi: A mundem? Për shembull, nuk na kanë treguar sa votues i ka qendra, sepse ish dashtë me qenë e dhënë që ish dashtë me marrë për bazë. Nëse I ka 20 000 votues imagjino çfar konfuziteti ke krijuar. Po të ishin 2000 votues masa e dëmit do të ishte shumë më e vogel. Nuk e kemi atë informacion. Desha vetëm edhe një sugjerim. Unë kërkoj, në vazhden e kësaj që tha Betimi, që në lokacionet e vjetra ku kanë qenë qendrat e votimit të vendosen njoftime të veçanta ditën e zgjedhjeve, ku I thuhet votuesve, që munden me u paraqitë në objektin e vjeter, në të cilën ne e kemi publikuar makinën kërkuese, "ju lutem të gjithë votuesit që e kanë pasur këtu qendrën e votimit le të shkojnë të shkolla 8 marsi, sepse atje janë bartë". Kështu operohet, dhe makinën kërkuese keni mundësi sado pak me ndryshuar këto ditë.

Betim Gjoshi: Kryetare, a bën? E di që kryetari u dhëmb sekretariatit çka po folim, por munden me të bë spot bile në RTK. Është TV-ja që transmeton në të gjitha gjuhët. Transmeton gratis. Nëse nuk munden me të bë spot, munden me të bë me titra me treguar që ndërrohet prej këtij vendi në këtë vend. Sepse, duhet me kry detyrën tonë. Kot ne folim, ata prap vazhdojnë me te veten, por ndoshta dikë e brenë ndërgjegjja.

Adnan Rrustemi: në aspektin zgjedhorë është vendi i rrezikshëm çka kemi marrë. Është levizje e votuesve pas të gjitha fazave.

Valdete Daka: Atëherë vazhdojmë me pikën tjetër që është shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-së për komunat Zveqan, Leposaviq dhe të tjerat, në qoftëse pajtoheni shkojmë me rend ashtu qysh i kemi. Atëherë komuna e Zveqanit

Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-ve, për komunat, Zveqan, Leposaviq, Mitrovica e Veriut dhe Zubin Potok për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017

Adnan Rrustemi: Unë nuk do të bllokoi procesin në këtë komunë, në këtë komunë nuk është përfill kriterin etnik që më vjen mirë shumë por nuk është përfill kriteri i ndarjes mes subjekteve politike, realisht sa krejt subjektet politike është KKZ-ja e Zveqanit që skan marrë mundim me përthi as për neve që se dim gjuhën sekretariati jonë, ka ma shumë sa krejt partit bashk me u ba, për mu po i bjen që cdo vendëvotim ka së paku një apo tre KKZ unë nuk e di se kush janë këta, sekretariati e merr dhe për këta përgjegjësin, unë kamë dyshimet e mija se kush janë këta, mirëpo këta e kanë gjetur këtë metod për me na sfidu neve domethan që tri mbledhje është e njëjta gjë mirëpo une nuk do te kundërshtoj do të votoj për, nuk kamë ndonjë problematik të madhe mirëpo as sekretariati nuk e ka kry punen e vetë, faleminderit.

Betim Gjoshi: A mundem kryetare!. Jane 13 venëvotime në Zveqan, janë 66 komisioner dhe 13 kryesues, 79 domethan me 8 veta gati se mesatarisht, kjo e spjegon se pse duhet me pas ose pse nuk duhet me pas komisioner në emër të KQZ-ës, në këtë rast që janë 26, përse nuk mundet me shku venëvotime me 6 ose me 7 në Zveqan, pikerisht për këtë formula jone ka qenë me 6 ose pse duhet me 8 unë spe kuptoj pse duhet 2 veta në këtë rast që është saktësisht 26 janë këta emra të KQZ-ës, unë nuk e di pse janë këta.

Sami Hamiti: Le ti shton ai i KQZ-ës 13, mbesin me 7 parimisht këtu vendëvotimet edhe përfundon kjo punë, nuk kemi çka me diskutu.

Betim Gjoshi: A mundem kryetare, se ka nevojë me qenë nga 2 KVV prej Komisionit Komunal Zgjedhorë ku janë të mjaftueshëm me shku me nga 1 këta, edhe partitë tjera me nga 1 veq që është përbërje në formulën e propozuar prej KQZ-ës dje, jo të propozuar të marrur vendim dje.

Nëse kështu është pa emra unë me automatizëm jamë që këta mi pas 13, nga 1 për vendëvotim, jo 26 edhe me kusht që këta ti dinë emrat kush janë këta.

Valdete Daka: Atëherë a pajtoheni që këtu me zvogëlu prej 26 ne 13, po de kjo OIK është KKZ-ja. 26 Po thotë 13.

Betim Gjoshi: Jo kryetare nuk është, dmth me 6 janë momentalisht KKZ-ët, ndoshta ka bërë ndonjë logaritje Adnani mi hek këto 13 I bie me 5, me 6 janë...

Valdete Daka: Kush është për...? Miratohet...

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për numrin e fletëvotimeve dhe broshurave të cilat shtypen dhe shpërndahen për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017

Betim Gjoshi: A bën kryetare, shiko na po kuptojmë që shtaja dje tha Samiu këtu në mbledhjen e Komisionit Qendror Zgjedhor që ka një tendencë me dominu një subjekt politikë se është mirë që ndonjë na është shkelur një e drejtë me jo përmes mënyrave të tilla me u mundu me blloku na I kem 6 subjekte të një komuniteti nuk ju ka dhënë dikuna jashtë komuniteti ju ka dhënë të njëjtit komuniteti dhe mirë është me pas gjithëpërfshirje bile ktu kemi tejkalu ligjin me zemërgjersi p.sh ja kemi dhënë prej 26 votime , me 23 I kryeson një subject politik që se kemi bërë se në Skenderaj 95% fiton një parti po si kemi dhënë kryesues I kemi dhënë barabarë edhe me ata që kanë fitu 2% me atë 95% këtu pe bojmë një të kalume të madhe po ka një tendencë që me pas komisionert në një parti tash masi po folum real unë jamë kundër këtu me qenë IGP-ja se IGP-ja është parti “Jedinstvena Goranska Partija” dhe nuk jeton në këtë komunë anjë goran dhe kësaj duhet më ia hjek meniherë , nuk ju ka dhënë asnjë komisioner vakatit ose komunitetit boshnjak I cili jeton në këtë pjesë mandje edhe këta 30 janë po të njëjtit subject të cilët janë të IGP-së se krejtë janë të një subjekti politikë edhe këta GJS-ë janë po të njëjtit subject politik d.m.th krejt këshilli I vendvotimit është I një subjekti politik këtu po ka pengesa se kanë leju as KKZ-ës nuk ja kanë marr nominimet e këtij subjekti duke u menduar me thirr në jo përçarje të kualicionit, ne të gjithë e dimë si janë tërheq kandidatët e një kualicioni kemi menduar dhe kemi vendosuar me vazhdu mi qertifiku njejtë, pa marr parasysh a është heq një pjesë e kualicionit se ka pasur një njoftim prej zyrës të lëshuar me kohë, kështu që pjesa e mbetur e kualicionit vazhdon më tutje me marr pjesë në zgjedhje, vazhdon më tutje me pas përfaqësim, nuk mundemi me ja u ndalu, kështu që hiqet jugp-ja edhe vazhdon më tutje ky komision I Këshillit të vendëvotimit, edhe nëse ka vakati nominime ose komuniteti boshnjak

nds-i ose kush ka mund ti dërgojnë se e kanë të drejtën të paktën në vendvotime ku janë të përfaqësuar ata. Faleminderit. Edhe nuk na takon neve si anëtarë të Këshillit Qëndrorë Zgjedhorë, se këtu bile ata që janë përfaqësues të komuniteteve është mirë bile intëresat e komunitetit të vet mi mbrojtë, jo interes e partive dmth të shohin edhe pjesën tjetër që nuk po l mbrojmë ne të partive të caktuara por, po l mbrojmë të komuniteteve.

Valdete Daka: Propozimi është që JGP të hiqet. A ka “Vakati” atje nominime?

Bajram Ljatifi: Kam pyetur anëtarete faktikisht edhe kryesuesin e KKZ-ës a ka nominime prej komunitetit boshnjak në fshatin gruacka, se në zgjedhjet e kaluara kemi pasur kryesuesin e atij vendvotimi në atë komunitet, por, tha nuk ka, edhe kanë vendosur prej një subjekti tjetër që me dërgu edhe anëtarë të komuniteteve tjerë.

Valdete Daka: Në qoftë se nuk ka ky komunitet atje nuk ka kënd e përfaqëson ajo parti. Atëherë JGP, propozimi është që JGP të hiqen, edhe a e prish kjo numrin?

Valdete Daka: A ka PKS-ja nominime?

Nexhmedin Hyseni, Koordinator i terrenit: E nderuar kryetare, të nderuar anëtarë, unë dy lista kam pranuar prej Lepasaviqit, lista e parë ka qenë me nominime nga PKS-ja ndërsa kur e kemi dhënë rekomandimin nga KQZ të bëjë plotësimin sipas kërkesave të KQZ-ës e kanë sjellë listën pa nominime të PKS-ës, dmth listën e parë e kemi, të gjitha nominimet janë, ndërsa në listën sot që kemi pranuar nga Lepasaviqi nuk janë.

Betim Gjoshi: A bënë kryetare? Po më vjen keq që po na bjen me fol neve anëtarëve , po Komisioni Qëndrorë Zgjedhorë e ka për detyrë me garantu gjithëpërfshirje për balancim të komunitetit, ne e kemi tejkaluar si shumicë edhe pse ju ka takuar partive parlamentare shumicë në Kuvendin e Kosovës me pas përaqësim janë terheq prej asaj pune mi dhënë hapësir një komuniteti tjetër mi inkuraju për me marr pjesë në zgjedhje, por, nuk mundemi me ja dhënë këshillat e vendëvotimit një subjekti politik. E gjithë kjo tendenc, ne nuk mund të flasim për Lepasaviq në situatë normale, nuk ja kanë marr nominimet atje, bile ka edhe të shtëna edhe me armë ne të gjithë e dimë nuk mund ta mbajmë të fsheht dmth ka kërcënime të vazhdueshme për këtë është dasht me reagu edhe ambasadës amerikane, edhe OSB-es, edhe neve, edhe të gjithë të tjerëve dmth është keq prej një anëtari të KQZ-ës me vazhdu të njejtin presion në institucionin tonë. Ne duhet ta heqim JGP-ën krejt këtu edhe me vazhdu, kjo është balanca e subjekteve të qertifikuara, unë nuk e di si nuk l pengon se ne e dimë se JGP-ja as nuk është parti parlamentare e para e punës, e dyta as nuk l takon atij komuniteti, e treta ai që e ka kryesuar atë komunitet ka qenë pjesë e një grupi parlamentar të cilit ju kanë keqpërdorë të cilët nuk janë as emrat e këshillave të vendëvotimit që nuk janë të atij, nuk reagon për këtë se po hyn një komunitet që nuk egziston hiq se pas tij po fshehet një subject politik, por po reagon se po l jepet e drejta një subjekti tjetër politik. Ne nuk mund të lejojm kësi diskutime në Komision

Qëndrorë Zgjedhorë, ne duhet ta ruajmë integritetin, ne nuk duhet ti kryejmë agjendat e asnjë subjekti politik I cili tenton me I mashtru edhe me dëmtu procesin zgjedhorë me 11 Qershor, edhe unë do te jemë gjithmonë në mbrojtje të procesit zgjedhorë anë e kënd Kosovës njejtë pa asnjë dallim dmth ndash le ti vij mërzy, do ta mbështet gjithkujt kur I shkelen të drejtat e veta, por, unë asnjëherë nuk jamë mi ndihmu dikujt me prish edhe me keqpërdorë procesin zgjedhorë, ashtu siq ka rënë në presione sekretariati, unë si anëtarë I Komisionit Qendror Zgjedhorë nuk e lejoj asnjë minutë me ra në presion siq ka rënë në presion KKZ-ja, se KKZ-ja është nën presion ta kemi të qartë, I kanë detyru anëtarët e KKZ-ës me jap edhe dorheqje, ne të gjithë e dimë, nuk ka një mbarvajtje të mirë të procesit, nuk po flasim këtu për Londër, jemi tu fol Laposaviq, ku po hiqen zvarr kandidatët që janë garu, ku janë detyruar mu terheq kandidatët prej listave, te trupa zgjedhore po bëhet presion mbi tap o bëhet presion edhe deri në KQZ-ën këtu, mua po më vjen qudi prej këtyre në Prishtinë qa I ka gjetë që po tuten, se për ata tjerët nuk e kam problem.

Sami Hamiti: Betimi e tha që ne po mundohemi me garantu një formul gjithpërfshirëse në tërë Republikën e Kosovës, po mendoj se ne nuk jemi të barabartë, nuk jemi këtë formul duke e aplikuar njejtë, 23 kryesues I ka Komuna e Laposaviqit, secilën komunë I ke 6, 7, 5 kryesues, ndërsa praktika që e kemi ndjek në komunat tjera e kemi ndjek të shpërndarë barabart, atëherë për qfar arsye duhet të jenë 23 kryesues këtu. Problem më I vogël përveq asaj që po provojnë me shti komisioner nën petkun e një komunitetit tjetër haptazi vërehet ajo punë edhe kjo tjetra që po provojnë me marrë krejt këshillat e vendvotimit me I kontrollu komplet kta jonë ka dojnë me kontrollu procesin zgjedhor në ditën e zgjedhjes më vjen keq që me inati e bënë këtë , më vjen keq ama duhet me than kështu nuk mundem me votu këtë kjo shihet haptazi për një tendencë që gjithqka me kontrollu një subject I caktum politik, ju zotri Nenad ju jeni këtu për me mbrojtë interest e komunitetit serb jo të një partie politike...

Adnan Rrustemi: Po nuk trajtohet ky rast tu marr kshtu sekuenca të veqanta menoq qe duhet me adresu policisë aty sdi qka duhet me bo amo duhet mu adresu në mënyrë të veqant që për krejt këto aspekte procesi duhet me pas vëmendje d.m.th nëse dojna me emru njerzë në këtë rast këta 29 të PKS-së të cilët sot po I emrojmë e neve po na jepin indikacione që këta zyrtar nuk kan me guxu me dal në ditën e zgjedhjeve e kot po I emrojmë po veq duhet me I lajmru policin për indikacione që I kemi , e kemi një plan të sigurisë e duhet me I njoftu për indikacione që I kemi për situatën konkrete , duhet me I garantu një zyrtari për me marr pjesë në proces.

Betim Gjoshi: Tash masi po dojnë me fol konkret , po flasim për secilën komunë që dojna në qofse e kaluam Laposaviqin po I tregojë zotriut në fjalë që JGP-ja udhëhiqet nga Adem Hoxha I cili ka qenë për 3 vjet në grup parlamentar në serbska të gjitha këto janë të Serbskaa listës janë 30 vetë...Dhe, unë e d'u integritetin e procesit zgjedhore per kosove per mu një është sepse per mu ska tjetër edhe nuk kena toleri ne as një vend të kosovës per me ta kujtu si komisjon

zgjedhor besoj se e din se kshillat e vend votimit I miraton vetëm KQZ-ja nuk është naj organ tjetër dmth si KKZ-ja mundet me bo qmos me lajmru edhe deputet por na e kemi per detyrë me siguru që procesi është I barabart duke u trajtu ne krejt kosovën edhe e kemi per detyr qe mos me ja lan ni subjektit politik në dor procesin se sa ja kemi nimu ne burrni tina me ja lan a e ka keqperdor a jo , porn a nuk guxojna me ja lan qata , dmth na duhet barabart me ja lan muni të gjithve edhe nuk e di tash me krejt këto matematika , ni subject politik po I ka minimum 4 antarë në KVV, ne vend se mu kan 1 I njo tjetres dmth ky indikacion është shum I ran për neve si komisjon zgjedhor kur thuhet prej ni antari të komisjonit zgjedhor se me than naj njeri ne rrugë nuk paraqet problem sepse e kan drejten me fol qka dush , na e kemi mbeshtet se është I njejt person kur ka qen e drejta e zotit mas pari ne anen e ti edhe gjdo here e ka pas kështu , por as një here nuk kena me mbeshtet per me keqperdor procesin me u bo mu bo proanr I procesit edhe me ndiku ne process dmth na kena me u mundu me rujt ni barabarsi të pakten qaq sa na lejon ligji edhe sa kemi mundesi dmth ne ja kemi dërguar KKZ-ës paraprakisht një formul që nuk ju ka përmbajtur duke u munduar për të bërë ligj në vete edhe tash e kemi për detyrë një vendim, në qoftëse nuk e repekton dikush vendimet e Komisionit Qendrorë Zgjedhor, sa për kujtesë është shkelle edhe është vepër penale , përveq disiplinore është edhe vepër penale dmth se është keqpërdorim I detyrës zyrtare, ndikim në procesin zgjedhor, mi keqpërdor detyrën zyrtare është vepër sipas kodit penal, edhe këtë kryeshefit egzekutiv I kërkoj me ja dërgu zyrtarëve komunal zgjedhor të cilët nuk e kanë respektuar, se në qoftëse atje dështon procesi, të parën punë që do ta bëjë kam mi paditë ata që nuk e kanë respektu vendimet tona edhe kanë me shku në burg, se nuk kanë më shku ata të shkretit anëtarët e komisioneve, këshillave të vendvotimeve siq kanë shku deri tash, kanë me shku kokat që po I udhëheqin. Faleminderit.

Valdete Daka: Edhe një shtesë, është e vërtetë që KQZ-ja e ka dërgu një formul KKZ-ve edhe ata nuk e kanë respektuar, e nuk është që ata e bëjnë formulën e na e respektojmë .

Adnan Rustemi: Unë po mendoj se kjo formulë dhe kjo tendenc nuk siguron integritet të procesit zgjedhor, nuk është e mundur të kemi integritet të procesit kur një subjekt politik janë gjithë anëtarve të KVV-s. Më vjen keq që po ndodh kështu, nuk munjim me votu me legjitimu një proces që nesoer është keq.

Valdete Daka: Mirë atëherë ne u pajtuam që mi heq, po u votu, vazhdojmë tutje. Mirë atëherë kush është për që të aprovohet kjo pa antare të EKPS-së , kush është për , kush është kundër , kush apstenon . vazhdojme me komunën e Zubin Potokut

Betim Gjoshi: Kryetare, situata është edhe ma rëndë , këtu e kemi përveq dy komisioner të një subjekti politik , tre vertetë mos të I hy ne hak , komplet të tjerët janë të një subjekti politik, do me thane të gjithë vendëvotimet janë të një partie, ne mundemi me bë sit të doni Zubin Potok , do me than po ja u lexoj ne 13 venëvotime, faktikisht në 14 vendëvotime që janë të komunitetit

shumicë, janë 3 komunitet të një partisë ndërsa komplet të tjerët janë 61 duke përfshi edhe kryesuesja e një subjekti politik, nëse doni i shpallemi sot rezultatet ose e miratojmë KKZ-ës, mua më vjen keq qysh një sekretariat është në gjendje me prurje propozim të tillë, sepse ligji i jep kur nuk kanë këto gadishmëri subjektet e reja është komuniteti, është OJQ-ja janë do me thanë të gjitha mundësit nuk i kanë ndjek asnjë nga këto veq mos të thojnë që kanë vendosë KKZ-të se edhe unë KKZ me kon qeshtu kisha vendosë pse me dal me votu pse ma mirë ma kollaj në mënyra të tjera.

Enis Halimi: Menjëherë mbas mbledhjes të djeshme të KQZ-së kemi drejtu me shkrim të Komisionit komunal të Zgjedhjeve në komunën e Zubin Potokut edhe kemi kërku të bëhen ndryshime sipas kërkesave që ka rekomandu këshilli i operacionit zgjedhor për mu miratu edhe ne KQZ, komisioni komunal i zgjedhjeve nuk e ka ndryshu formën përjashtimisht tek kryesuesët e vendotimeve d.m.th edhe ka qëndru dhe qëndrojnë edhe me proces verbal të KKZ mbrapa këtij propozimi tash na e kena plasuar rekomandimin e KQZ-së atje...

Valdete Daka: Vazhdojmë me Mitrovicën e Veriut...

Betim Gjoshi: Kryetare për mu veq te na kallxojnë për një komunitet goran se për kit pjes se nuk është problem, ska komunitet goran ne Mitrovicë, boshnjak ka ama goran ska se une kom lindë ne mitrovic e di, goran ka ne Prizren kerkun tjetër ska edhe ne dragash Kryetare se na po bijna shumë ne pozit të keqë, paramendo na e kemi kufizu po e zaimë vetëvendosjen që është subjekti i 3 ne parlamentë në kuvendin e Kosovës mos me pas vend votimet mos me pas as qysmen e vendvotimet, edhe që ka ni për bamje të popullsis kundër rreth 20-30% të kti komuniteti ja kemi dhan një në gjdo vend votim që nuk egziston fare se pe dijmë që është mashtrim mujna me kapercy qka doni thash edhe 1 here nuk është problem i madhë se nuk është kosova veq e jemja, mas pakti u dasht mu kanë e jona është dasht me kallxu se me makin votimi që i ka për kundër, ama kjo qka ka bo ksaj here sekretari në KKZ-ë, edhe me KVV është blerje e paqës edhe sja falë këtë kërkush prej 11 qeshorit me bo me ndodh akses ma i vogli nuk ja falë, se kta jan bash autor që na kan prur neve, se une edi qysh kryhet puna se njejt ka ndodhë. Edhe atë dit në zyren e regjistrimit per parti politike qoftë, që spranohet e as nuk shitet për as një qmim at here edhe ata mendojnë ndryshe 26. Kryetare këtu as mat voglin inicjativ nuk e ka bër sekretariati për me kry kit far problem me thanë menjë here e kan marrë përgjigjen prej komisionit komunal zgjedhorë qata e kan prur këtu edhe as një tentativë se kan bo e as një mundë, se kan marrë për me e kry këtë temë. Veq bjere këtu edhe hajde ta kryjmë është dita e 3 që neve ata na trajtojnë, sikur mu kan na kome dit qka deri sa ju as një inicjativ se merrni për me provu për me gjetë zgjidhje. Sodë është ë treta here që ne nuk mundemi me bo zgjidhje. Për këto 3 komuna, provone jo ju ne komisionin komunal kan thanë kështu. Ka formulë tjetër që na nuk i miratojmë spo edi une po e shof ni

eglizhencë totale kështu. Mos inicjativ totale për me gjetë për ndryshe na për me gjetë, at here na nuk kemi koh për me marr na me ta.

Sami Hamiti: M'u po më vjen shumë keq që komisioni qëndror i zgjedhjeve ka ra në nivel të shqyrtimit administrative mos e konsidero veten trampolinë të pranimit edhe të gjutjes në komision duhet të dijmë se kur të vij një qështje edhe se si duhet të trajtohet në administratë për me ardhë në komisionë për me shqyrtu edhe për me vendosë

28. Vetëm desha që këta është mir me u bo të sigurtë me na tregu se kanë problem me komunikim me ata na at here na e kemi partner me ciltë që jemi në bashkpunim me ta ekzultivishtë për pjesë veriore atje të republikës së Kosovës edhe është mir që të inkuadrohen mrena 24 ore deri nëse që të bëhet qka osht e mundshme me ta edhe të kontakohet conform ideva tona të zbatohen nga KKZ për ndryshe qysh shpjegohet nga koleget ma heret të gjithë qka ndodh atje jashtë vendime tona është një veper penale që do të ballafaqohen atje prej 11 qeshorit

Valdete Daka: Kush është për? E bartim përgjegjësin ditën e zgjedhjeve vet ata. Kush është kundër? Kush abstenon?

Betim Gjoshi: Kryetare e kisha dërguar një mesazh, edhe ju është mirë me ja u drejtu. Neve këtu po na vij nga 10-15 mijë vëzhgues po na akreditohen gjithmonë edhe jashtë subjekteve të këtyre OJQ-ve, na mbyten qarru ditën e zgjedhjeve disa votime familjare, jo njërit I ka shkrep aparatit I ka fotografuar, I kisha lut me shku në veri mi vëzhgova zgjedhjet most ë na shesin prralla neve me na tregu, se këtu në Prishtinë është lehtë mi vëzhgu zgjedhjet, le të shkojnë në veri po e shoh që janë edhe disa përfaqësues këtu, marrin fonde taksapaguesve edhe amerikan edhe të tjerë le të shkojnë le ta mbulojnë terrenin mi vëzhgu zgjedhjet në tërë Kosovën.

Vakdete Daka: Unë kam kërkuar nga të gjithë vëzhguesit që mu fokusi në pjesën veriore, normalisht që gjithandej por, me një fokus të posaqshëm në veri.

Adnan Rustemi: Vetëm diçka, unë po du me arsyetu votën time për këto tri komuna, katër a tri sa të jenë, unë po them qofsha I gabuar por, besoj që dita e zgjedhjeve ka me na tregu se kemi pasur të drejtë ne që kemi votuar kundër. Keni me pa se sot është duke u bërë presion, atje sot është ka përdoret dhunë ndaj njerëzve që po duan ta shfrytëzojnë të drejtën e votës edhe me votuar me vullnet të lirë. Ndërsa llogarit që ka me ndodh atje ku komplet trupat zgjedhore I menagjon një subjekt politik.

Valdete Daka: Rekomandimi për numrin e fletëvotimeve dhe broshurave të cilat shtypen, shpërndahen për zgjedhjet e parakohshme. Po urdhëro.

Enis Halimi: Bazuar ne nenin 87 që flet për materialin e fletëvotimeve dmth sekretariati ka përpiluar dokumentin mbi kalkulimet për numrin e fletëvotimeve dhe listat e kandidatëve apo broshura për zgjedhjet e parakohshme , llogaritja dhe numri I vendëvotimeve të rregullta dmth llogaritja bëhet në atë mënyrë që çdo vendvotim bëhet rrumbullaksimi I fletëvotimeve, duke e minusuar në intervalin 100 deri 149, ndërkaq për fletëvotimet e dyfishta është thënë që në qendrat e votimit ku ka deri në 5 vendvotime sasia e fletëvotimeve në vendvotimin e dyfisht, duke e plotësuar në intervalin nga 1-49 fletëvotime më shumë se numri I votuesve dhe në qendrat e votimeve ku ka më shumë se 5 vendvotime sasia e fletëvotimeve në vendvotimin e dyfishtë shtohet duke plotësuar intervalin nga 5 1 deri 99 fletëvotime më shumë se numri I votuesve, Po ashtu edhe për sa I takon fletëvotimeve rezervë që kalkulohet duke rrumbullaksuar kufirin e poshtëm deri në plotësimin e dengut prej 50 fletëvotimeve të numrit prej 5 përqind të votuesve për qendrat e vendvotimit, kjo përveç në rastet kur numri I votuesve është më I vogël se 50 rrumbullaksohet në numrin e fletëvotimeve në deng. Bazuar në listën përfundimtare të votuesve, gjithsej votues me të drejtë vote janë 1872941 votues dhe shtypen 1785650 fletëvotime, ju I keni të prezantuara edhe në tabelën që e keni bashke të lidhur me këtë . Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit krye shef. E keni listën e komunave me numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve dhe broshurave të cilat do të dërgohen në shtypje.

Valdete Daka: Kush është për? Faleminderit...Miratohet...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
